



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Publikimi u bë në datë 01.07.2024, data e mbylljes së procesit të konsultimit ishte 29.07.2024.

Të interesuarit ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektligjin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: Eriola.Kocileri@meki.gov.al

3. Metoda e konsultimit

Në kuadër të procesit të derregullimit, Qeveria Shqiptare ndërmori hapat për të identifikuar bashkërisht të gjitha ato hallka burokratike dhe ato ngarkesa në procedurat administrative që mund të eliminohen dhe për ta përmirësuar bashkërisht më tej klimën e biznesit. Rregulla të shumta për biznesin mund të pengojnë sipërmarrjen dhe të ulin investimet, prandaj derregullimi konsiderohet një reformë e rëndësishme për përmirësimin e klimës së investimeve. Kjo ndërhyrje është në funksion të përmbushjes së Programit Politik të Këshillit të Ministrave 2021-2025, përkatësisht në fushën e inovacionit dhe teknologjisë së informacionit, i cili lidhet me shtimin dhe promovimin e shërbimeve dixhitale, e-shërbimeve, për qytetarët dhe biznesin përmes konsolidimit të infrastrukturës dixhitale duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme. Programi e shikon zhvillimin e TIK dhe e-shërbimet të lidhura ngushtë me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Projektligji gjithashtu u publikua, në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJKP) nga data 01.07.2024 deri me datë 29.07.2024, por nuk ka pasur asnjë koment për të pavarësisht se numri i shikimeve është 557.

4. Palët e interesit të përfshira

Nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: 1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; 3) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektligjin, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: Eriola.Kocileri@meki.gov.al

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Nuk ka pasur asnjë koment.

Çështja adresuar	e	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
		.			-